

Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16, të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), të nenit 17, paragrafi 17.4a, të Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 10/07 maj 2015), të nenit 190 të Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 39/01 tetor 2008), të nenit 13 të Statutit të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Trafiku Urban" në mbledhjen e jashtëzakonshme merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për shpalljen e konkursit publik për katër (4) pozita për anëtarë të bordit të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Trafiku Urban".

Neni 2

Obligohet Sekretariati i Ndërmarrjen Publike Lokale "Trafiku Urban", ta shpallë konkursin së paku në një (1) gazetë të përditshme në Republikën e Kosovës, si dhe në faqet zyrtare të Ndërmarrjes.

Neni 3

Konkursi duhet të përmbajë kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara me Ligjin nr. nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, si dhe Statutit të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban".

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e marrjes së tij.

U dorëzohet:

- NPL "Trafiku Urban;
- Në dosje.

Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve:

- Hetem Kupina,
- Lirie Avdiu,
- Genc Bashota,

Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), të nenit 174, paragrafi 174.1, të nenit 190 të Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 39/01 tetor 2008), të nenit 13 të Statutit të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Trafiku Urban" në mbledhjen e jashtëzakonshme merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për shkarkimin e bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Trafiku Urban".

Neni 2

Bodi i ri i drejtorëve do të emërohet me një vendim tjetër të miratuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve sipas Ligjit për Ndermarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Komisioni komunal i aksionarëve, me datë 14.04.2017 ka pranuar një petition të nënshkruar nga 168 punëtorë të ndërmarrjes Trafiku Urban, për mbështetjen e kryeshefit ekzekutiv z. Halil Mustafa, me arsyetimin se i njëjti ka stabilizuar gjendjen e ndërmarrjes, ka rritë pagat e punëtorëve duke ju siguruar të ardhura financiare më të mira se para tre viteve, andaj dhe dëshirojnë të vazhdojnë nën menaxhimin e këtij kryeshefi, të cilin Anëtarët e këtij Bordi të drejtorëve të kësaj ndërmarrje, të përzgjedhur në rrethana të dyshimta dhe persona që nuk i plotësojnë kushtet e përshtatshmërisë profesionale siç është përcaktuar në nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, me datë 27.02.2017, kanë shpallur konkurs për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv, njëherit duke caktuar si ushtrues detyre sekretarin e kësaj ndërmarrje z. Hafir Hamiti, dhe duke shkarkuar kryeshefin aktual z. Mustafa, me një vendim të nxjerr të pa protokolluar dhe të pavulosur.

Që nga përzgjedhja e këtyre anëtarëve në bordin e drejtorëve, në një proces që është përcjellë me parregullësi procedurale, por edhe qasje jo korrekte të ish anëtarëve të komisionit komunal të

aksionarëve në vlerësim jo adekuat të kandidatëve, ndërmarrja ka has ne bllokada të ndryshme në procese shumë të rëndësishme.

Emërimi i njerëzve jo adekuat/ jo profesional ka ndikuar që kjo ndërmarrje të ballafaqohet me ngecje të ndryshme gjatë reformimit të ndërmarrjes. Ka rrezikuar shumë procese të rëndësishme të përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë për blerjen e 51 autobusëve të kësaj ndërmarrje me Banken për Rindertim dhe Zhvillim. Marrëveshje e cila synon të bëjë reformimin total të Trafikut Urban, përveç blerjes së 51 autobusëve që do të jenë në shërbim të qytetarëve të komunës së Prishtinës, gjithashtu edhe renovimin e garazhes së Trafikut Urban dhe planin e qëndrueshëm të mobilitetit urban.



Blokadat e ndryshme dhe veprime të jashtëligjshme të marra nga ky Bord, kanë bërë që punëtorët e kësaj ndërmarrje të mbesin pa paga, autobusët të mos kenë mundësi të qarkullojnë dhe plotësojnë nevojat e qytetarëve, të shkaktojnë kaos në Trafik Urban, të rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare, të zvarrisin procedurat për blerjen e 21 autobusëve të tjerë, për arsye të ndryshimit të informatës së biznesit, rrjedhimisht bllokimit të xhirollogarisë së ndërmarrjes, duke mos lejuar kryeshefin ekzekutiv të ketë qasje në llogari me vendime krejtësisht të paligjshme.

Së fundmi, kryesuesi i këtij bordi të drejtorëve, ka deklaruar publikisht përmes një interviste të dhënë në njërin prej televizioneve, se Komuna e Prishtinës nuk ka marrëveshje me Kompaninë "IVECO" nga Republika e Çekisë, pasi sipas tij autobusët kanë ardhur nga ndonjë rezervë e shtetit të Kroacisë dhe si i tillë këta autobusë janë të ngjyrosur dhe vërehen nga ngjyra më shumë nuanca por dhe nga tabelat e regjistrimit të këtyre autobusëve. Për këto shpifje nga kryesuesi i këtij bordi, është ushtruar Padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, nga aksionari i vetëm i kësaj ndërmarrje sipas dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Shpifjet e lartëcekura, kanë ndikuar negativisht në prestigjin që ka arrit kjo ndërmarrje pas rimëkëmbjes gjatë tri viteve të fundit. Ka ndikuar në humbjen e besimit të qytetarëve të komunës së Prishtinës dhe rrjedhimisht në përformancën e dobët financiare, veprime të cilat janë në kundërshtim me atë se për çka është i thirrur.

U dorëzohet:

- Bordit të drejtorëve të NPL "Trafiku Urban"
- Në dosje.

Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve:

- Hetem Kupina, 
- Lirie Avdiu,
- Genc Bashota. 

Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 190 të Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 39/01 tetor 2008), të nenit 13 të Statutit të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Trafiku Urban" në mbledhjen e jashtëzakonshme merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për shfuqizimin e Vendimeve të marra me datë 13.02.2017 nga Bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Trafiku Urban" Sh. A. Prishtinë.

Neni 2

Vendimet e cekura në pikën I, janë:

1. Vendimi për shkarkimin e z. Halil Mustafa nga pozita e kryeshefit ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale "Trafiku Urban Sh.A. Prishtinë;
2. Vendimi për emërimin e z. Hafir Hamiti, ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale "Trafiku Urban Sh.A. Prishtinë.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, përtërihet fuqia ligjore e Vendimit nr. 471 të datë 28.05.2014 për emërimin e z. Halil Mustafa, kryeshef ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale "Trafiku Urban Sh.A. Prishtinë.


Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- NPL "Trafiku Urban;
- Në dosje.

Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve:

- Hetem Kupina, 
- Lirie Avdiu,
- Genc Bashota. 